

V E N D I M
Nr.541, datë 1.8.2003

**PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK TË GJASHTË
OBJEKTEVE DHE TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, TË ISH- BRIGADËS SË
KËMBËSORISË, NË SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin në administrim të Ministrisë së Rendit Publik, për nevoja të rajonit të policisë së Shijakut, të 6 objekteve, së bashku me truallin funksional të ish-brigadës së këmbësorisë, në Shijak (reparti ushtarak 8800, Shijak), të cilat deri tani kanë qenë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Ministrisë së Rendit Publik i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në këtë vendim, t’i tjetërsojë ose t’i japë në përdorim të tretët.
3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të bëjë kalimin në administrim të Ministrisë së Rendit Publik të kësaj prone të paluajtshme, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Ministria e Rendit Publik të përballojë shpenzimet për mirëmbajtjen e pronës së dhënë në administrim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano